

ARGUMENTIMI I APLIKIMIT

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË BACHELOR “Zootekni dhe Siguria e Produkteve blegtorale”

I. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT QË PROPOZOHET PËR RIORGANIZIM

1.1. Të dhëna mbi programin e studimit.

Programi i studimit “Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale” është miratuar me urdhër Nr. 406, Datë 25. 07. 2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Kurrikula aktuale e këtij programi, për nga objektivat e saj, i përgjigjet mirë prirjeve të zhvillimit të sektorit të blegtorisë dhe sigurisë së produkteve blegtorale primare në vendin tonë. Ajo i pajis të diplomuarit në këtë program, me kompetenca dhe aftësi për të zhvilluar dhe drejtuar/manaxhuar: (i) teknologjitë e të ushqyerit, përmirësimit gjenetik dhe mbarështimit të kafshëve të fermës blegtorale, (ii) cilësinë dhe sigurinë në të gjitha hallkat e prodhimit të produkteve blegtorale brenda fermës (produktet primare, pra jo në hallkat e mëtejshme të zinxhirit që lidhen me përpunimin industrial dhe tregtimin e tyre), (iii) mirëqenien dhe masat parandaluese për shëndetin dhe crregullimet shëndetsore të kafshëve/tufave, që lidhen me teknologjitë të ushqyerit dhe mbarështimin e tyre.

Në tërësi, kurrikula aktuale është e modelit klasik dhe ka një strukturë e raport midis teorisë dhe praktikës, i cili është brenda kriterëve ligjore në fuqi. Formimi praktik është i parashikuar kryesisht në formën e mësimëve praktike në auditor (ushtrime, punë laborator, praktikë demonstrimi, eskursione mësimore), krahas leksioneve. Forma e praktikës profesionale në ferma/biznese zë një pjesë shumë të vogël në strukturën e kurrikulës me vetëm 5 ECTS dhe 5 javë mësimore. Në përfundim të studimeve zhvillohet provimi përfundimtar të cilit i janë kushtuar 5 ECTS.

Ky program studimi, ashtu si edhe disa programe të tjera në Universitetin tonë, po përballët aktualisht me dy problematika: (i) *ulja e ndjeshme e numrit të maturantëve që aplikojnë dhe i studentëve në këtë program* si dhe (ii) *punësimi i pamjaftueshëm i të diplomuarve në fushën profesionale për të cilën kanë studjuar ata.*

Zhvillimet demografike në vendin tonë kanë çuar në uljen shumë të shpejtë të numrit të nxënësve dhe maturantëve, në mënyrë të vecantë në rrethe dhe rajonet rurale të vendit. Kjo është reflektuar edhe me një *prirje të uljes së numrit të maturantëve* që aplikojnë dhe regjistrohen edhe në disa programe studimi, përfshirë edhe programin e studimeve në fjalë. Në mënyrë të vecantë, vihet re ulja e numrit të studentëve të rrethëve dhe zonave rurale të vendit, nga ku duhet të vinin pjesa më e madhe e studentëve, motivimi i të cilëve ndoshta do të ishte ndoshta më i madh dhe ata mund për të punësoheshin më shumë, sepse ata jetojnë në rajonet ku janë fermat bujqësore, blegtorale dhe biznese të tjera të lidhura me to. Nga ana tjetër, janë ulur shumë prurjet nga shkollat e mesme profesionale, edhe pse 9 shkolla të mesme profesionale kanë programe të bujqësisë dhe blegtorisë dhe rreth 11 të tjera kanë programe të ekonomisë dhe turizmit. Dhe shkaku për këtë të fundit nuk është vetëm pragu i mesatares, sepse kjo prirje vihet re edhe në programet 2-vjecare post-sekondare, në të cilët nuk ka prag të notës mesatare për pranim.

Ndoshta për studentët e zonave rurale e largëta një rol luan kostoja e jetesës që kanë studentët në Tiranë, ndërkohë që tarifa e studimeve është thuajse e pa konsiderueshme.

Një sfidë tjetër është **hapësira e tregut të punës** që krijon sektori i blegtorisë dhe nënsektorët e lidhur me të, sidomos hallkat e zinxhirit ushqimor brenda fermës, agroturizmi, ndikimi i blegtorisë në mjedis dhe blegtoria ekologjike. Hapësira e tregut të punës duhet konsideruar në të dy sektorët, në sektorin privat dhe atë publik.

a) Hapësira e tregut të punës në sektorin privat. Sektori i blegtorisë zë aktualisht rreth 52% të prodhimit bujqësor, krahasuar me rreth 42% që zinte ai në vitin 1992 dhe rreth 35 % në vitet 80-të, cka tregon një prirje në rritje. Struktura e sipërmarrjes në këtë sektor mbizotërohet nga fermat e vogla familjare. Megjithatë, po rritet numri i fermave të mesme dhe të mëdha, cka po stimulohet edhe nga rritja e mbështetjes financiare, të brendshme dhe nga fondet e BE. Rritja e fondeve për bujqësinë dhe blegtorinë është një premisë e rëndësishme për rritjen e madhësisë së fermave (në 10 vitet e fundit ajo është rritur me rreth 15%, një rritëm ky ende i ulët), modernizimin teknologjik të tyre, rritjen e prodhimit të sigurt të produkteve, si dhe drejtime të tjera të zhvillimit të lidhura me këtë sektor. Nisur nga përvoja e vendeve të tjera, nga fakti që ky sektor është prodhuesi i produkteve shtazore, që zënë bashkë me ato të peshkut rreth gjysmën e ushqimit të njeriut, si dhe nga profili i të ushqyerit me mbizotërim të ushqimeve shtazore (qumësht dhe nënprodukte të tij, mish dhe nënprodukte të tij, vezë dhe me pak peshk) të popullsisë së vendit tonë, duket se pesha që do të zë ky sektor, brenda bujqësisë, do të vazhdojë të rritet. Nga ana tjetër veprimtaria e këtij sektori por ndërthuret, gjithnjë e më shumë, me hallkat e zinxhirit dhe sigurisë së produkteve shtazore primare, me industrinë e ushqimeve dhe inputeve të tjera për blegtorinë, agroturizmin, mjedisin, ekonominë e prodhimit blegtoral, si dhe veprimtaritë e tjera të investimeve financiare bankare të lidhura me blegtorinë.

Duke u nisur nga të gjitha këto prirje të zhvillimit të sektorit të blegtorisë, duket se ky sektor gëzon potencial për të krijuar një treg të konsiderueshëm pune, i cili kërkon kualifikime bashkëkohore profesionale edhe të nivelit të Bachelorit. Për më tepër, ky treg pune në sektorin privat do të konsolidohet më tej krahas implementimit, në sipërmarrjet e këtij sektori, të standarteve të BE që lidhen më vlerësimin e monitorimin e cilësisë, sigurisë së produkteve, ndikimin në mjedis si dhe ato të mbështetjes financiare, për të cilat fermat dhe sipërmarrjet do të kenë më shumë nevojë për asistencën e specialistëve që kanë formimin universitar në fushën e zooteknisë dhe sigurisë së produkteve blegtorale primare. Por, aktualisht tregu i punës në sektorin privat, për këtë figurë profesionale, nuk është i strukturuar për të thithur numër të mjaftueshëm të diplomuarish të nivelit Bachelor. Përgjithësisht, sektori privat akoma nuk është ndërgjegjësuar për nevojën e specialistëve të nivelit Bachelor. Edhe ato fermat e mëdha që ekzistojnë kërkojnë specialistë të nivelit Master. Në vendin tonë akoma nuk është e zakonshme që drejtuesi i një ferme të madhe apo të mesme të jetë i kualifikuar në nivelin Bachelor (rreth 3% e fermerëve kanë arsim të lartë, 34% kanë kryer arsimin e mesëm profesional, rreth 60% janë me arsim bazë ose atë fillor). Gjithashtu, akoma nuk ka incentiva nxitëse të mjaftueshme për të rinjtë e diplomuar në nivelin Bachelor, për të krijuar ferma apo biznese të tjera në këtë sektor.

b) Hapësira e tregut të punës në sektorin public. Përafrimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor rregullator të vendit tonë me atë të BE në fushën e bujqësisë, blegtorisë, si dhe cilësisë dhe sigurisë në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor kanë filluar të japin efektet në organikat e strukturave dhe institucioneve qendrore, rajonale dhe vendore të manaxhimit, inspektimit dhe ekspertizës edhe në sektorin e blegtorisë dhe të nënsektoreve të tjerë të lidhur me to. Kjo do të çojë në zgjerimin e tregut të punës në sektorin publik për të diplomurit në fushën e zooteknisë dhe sigurisë së produkteve blegtorale primare. Megjithatë ende ekzistojnë mospërputhje dhe mangësi të konsiderueshme në kuadrin aktual rregullator që i përket këtij sektori (sidomos në ligjin e blegtorisë, ligjin e Shërbimit Veterinar, ligjin e zhvillimit rural, ligjin e

ushqimit si dhe listën kombëtare të profesioneve), të cilat kanë përcaktime jo të plota që çenojnë fushën e ekspertizës së të diplomuarve në këtë program.

Për vlerësimin afatgjatë të prirjeve të zhvillimit të tregut të punës edhe në këtë sektor mund të na shërbej si referencë përvoja e vendeve të reja të BE, meqënëse bujqësia, blegtoria, mjedisi dhe siguria ushqimore janë sektorët/nësektorët ekonomik të vendit tonë që përfitojnë dhe do të përfitojnë mbështetjen më të madhe financiare nga BE. Përvoja e vendeve të BE me një madhësi të krahasueshme me vendin tonë (p.sh. Lituania, Sllovenia, Letonia), tregon se tregu i punës në sektorin privat dhe atë publik mund të thithë një numër të moderuar të të diplomuarve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare në drejtimin e zooteknisë, i cili është i shkallës së një grupi mësimor prej rreth 25 studentë/vit.

1.2. Argumente për riorganizimin e programit.

Prirjet e trajtuara më sipër për prurjet e studentëve dhe hapësirën e tregut të punës në sektorin privat dhe publik të lidhur me blegtorinë, janë udhërrëfyese për përshtatjen e ofertës akademike në këtë drejtim studimi, me synimin që të diplomuarit të kenë formimin teorik dhe praktik profesional që kërkon zhvillimi afatmesëm dhe afatgjatë i këtij sektori, si dhe ata të kenë mundësi të punësohen sa më herët në fushën profesionale për të cilën kanë investuar tre vite studimesh universitare.

Shumë studime mbi punësimin e të diplomuarve në vendin tonë dhe në vendet e tjera të Ballkanit, tregojnë se formimi praktik është ndër treguesit e rëndësishëm për punëdhënësit në rekrutimin e të rinjve. Për këtë arsye, një ndër rrugët e rëndësishme që rekomandohet për rritjen e shkallës së punësimit të të diplomuarve është forcimi i formimit praktik si dhe integrimi i të rinjve që gjatë kohës së studimeve në tregun e punës të fushës/sektorit përkatës. Strategjia Kombëtare e Arsimit (kreu Arsimit i lartë) 2021-2026 (www.arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026), e shpallur për diskutim publik, identifikon shkallën akoma të lartë të papunësisë së të diplomuarve në vendin tonë dhe hendekun teori-praktikë në formimin e studentëve që krijon vështirësi për përfshirjen e studentëve në tregun e punës (fq. 58). Ky dokument e konsideron organizimin e praktikave të studentëve nëpërmjet marrëveshjeve të formalizuara që institucionet të arsimit të lartë zhvillojnë me institucionet publike, agjencitë, bizneset dhe kompanitë private, si një garanci për një ndërlidhje më të mirë të programeve të studimit me nevojat e shoqërisë, ekonominë dhe kërkesat e tregut të punës (fq. 58). Për rritjen e cilësisë dhe orientimin më të mirë të studimeve universitare kah kërkesave të tregut të punës, Strategjia përcakton dy objektiva kryesorë që synojnë riorganizimin e programeve të studimit (objektivi specifik: C1, fq. 90) si dhe ndërlidhjen e arsimit të lartë me tregun e punës (objektivi specifik C3, fq. 91).

Modelet e studimeve universitare që e realizojnë më mirë ndërlidhjen e studimeve universitare në auditor me praktikën, si dhe janë më të suksesshme në rritjen e shkallës së punësimit të hershëm të të diplomuarve edhe në fushën e bujqësisë, janë studimet universitare të integruara me praktikën, sidomos “*Arsimi i lartë Dual*” (si forma më e avancuar), ku formimi universitar është rezultat i kombinimit, thuajse në mënyrë të barabartë, i formimit teorik me atë praktik direkt në sipërmarrje. Ky model i arsimit të lartë universitar është më i zhvilluar në Gjermani, por ai është i përhapur edhe në vendet e tjera europiane, sidomos në universitetet e shkencave të aplikuara, si Austria, Zvicra, Finlanda, Holanda, Danimarka, Sllovenia, etj.

Me qëllim gjetjen e rrugëve për rritjen e shkallës së punësimit të të diplomuarve në fushën e zooteknisë, Universiteti ynë aplikoi, së bashku me dy universitete të BE (University of Applied Sciences Nürtingen-Geislingen -NGU, Gjermani, si universiteti drejtues i projektit, dhe Savonia University of Applied Sciences - Savonia UAS, Finlandë) si dhe disa universitete shqiptare (Universiteti “F.S. Noli” Korçë, Universiteti “H. Prishtina” Prishtinë, Universiteti “I. Boletini” Mitrovicë), si dhe 7 institucione të tjera

partnere (si Work-life partner – WLP) nga vendi ynë dhe Kosova, të cilët veprojnë në fushën e blegtorisë, agrobiznesit dhe sigurisë së produkteve blegtorale në programin Erasmus plus, për projektin *"Dual Curricula - Study and Work Practice in Agriculture and Food Safety / DualAFS"*, (Erasmus + Capacity building in the field of Higher Education 619178-EPP-1-2020-1-DE-EPPKA2-CBHE-JP). Ky projekt cili ka filluar të zbatohet që në 15 janar 2021.

Objektivi kryesor i këtij projekti Erasmus është ***riorganizimi i programit aktual të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Zootekni dhe Siguria e produkteve blegtorale" në Universitetin tonë*** dhe i programit Bachelor "Agrobiznes" në Universitetin "F.S. Noli" të Korcës, në formën e programeve të studimeve të integruara me praktikën, të përafruara me arsimin e lartë profesional Dual, mbështetur kryesisht në përvojën e universiteteve partnere në projekt, NGU dhe Savonia UAS, si dhe të disa universiteteve të tjera (si Hochschule Weihenstephan, Hochschule Dresden, Duale Hochschule Stuttgart, Gjermani; Aeres University of Applied Sciences dhe Van Hall Larensten University of Applied Sciences - Hollandë, University of Applied Sciences in Agriculture, Forestry and Food, Bernë, University of Applied Sciences Zürich- Zvicër, Universität Hohenheim, Gjermani, etj.).

Forcimi i formimit të studentëve në studimet Bachelor në fushën e bujqësisë ka filluar të reflektohet edhe në kurrikulat e universiteteve klasike (research-based). Një model i tillë është ai i Universitetit Hohenheim – Stuttgart, Gjermani (prej të cilit UBT ka marrë përvojë për shumë drejtime studimi në 30 vitet e fundit). Ky universitet afron studime Bachelor me një "trung" të përbashkët prej 3 simestrash në shkencat bujqësore dhe profilizim në simestrat IV, V dhe VI në 12 profile të ndryshme (një prej tyre është "Zootekni"). Ky program studimi përfshin një opsion me 2 simestra të plotë praktikë profesionale, përfshirë edhe temën e Bachelorit, për studentët të cilit janë më shumë të interesuar për studimet e aplikuara në ferma/biznese në fushën e bujqësisë. Karakteristike për studimet në shkencat bujqësore në shumë vende është praktika profesionale në fermë, të paktën për një simestër, përpara fillimit të studimeve universitare ose, më së voni përpara thellimit profilizues në dy simestrat e fundit (V+VI).

Edhe në vendin tonë ekzistojnë përvojat e para të studimeve të integruara me praktikën. Përvoja e parë është ajo e Uniuersitetit të Durrësit në fushën e manaxhimit të bankave dhe të turizmit, ku praktika zë rreth 50% të të gjithë studimeve të ciklit të parë. Programi më i ri i miratuar është Bachelor në "Banking dhe Financë e aplikuar", i Universitetit të Neë York-ut Tiranë i miratuar nga MASR në korrik 2020. Ky program përmban 2 simestra praktikë profesionale në biznes nga 6 simestra gjithsej, pra 60 ECTS praktikë profesionale në biznes + 120 ECTS teori në auditor.

Realizimi i këtij objektivi kryesor të riorganizimit të programit në këtë projekt Erasmsu mbështetet nga objektivat e tjera të tij që janë krijim kapacitetesh (capacity building), përkatësisht (i) zhvillimi i kapaciteteve për e-Learning sipas përvojës kryesisht të Finlandës, (ii) rritja e kapaciteteve akademike (trajnimi i stafit, zhvillimi i infrastrukturës didaktike) të njësive akademike implementuese të kurrikulës, (iii) shkëmbimi i studentëve të programit të riorganizuar, (iv) zhvillimi dhe institucionalizimi i bashkëpunimit të universiteteve me partnerët (ferma, biznese, institucione publike - WLP) që kontribuojnë në formimin praktik të studentëve, si dhe (v) zhvillimi i Lifelong Learning (LLL) si dhe formave të tjera të bashkëpunimit të IAL me fermat dhe bizneset në sektorin e blegtorisë dhe nënsektorët e lidhur me të.

1.3. Objektivat e riorganizimit të programit Bachelor.

Qëllimi kryesor i riorganizimit të programit është *rritja e cilësisë së formimit profesionale, teorik dhe praktik, të të diplomuarve, përmes orientimit më të mirë të tij kah (i) prirjeve aftamesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të sektorit të blegtorisë e nënsektorëve të tjerë të lidhur me të, si dhe (ii) kërkesave të tregut të punës që u përket atyre, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.*

Në funksion të këtij qëllimi, riorganizimi i programi është fokusuar në *forcimin e formimit praktik përmes integritit të pjesës teorike me atë të praktikës profesionale në fermë/sipërmarrje, pa cënuar formimin teorik që kërkonë standartet e cilësisë për ciklin e parë të studimeve.*

Forcimi i formimit praktik të studentëve do të realizohet përmes:

1. Integritit të pjesës së studimeve në auditor (kurrikula teorike) me praktikën në fermë/biznes (kurrikula praktike).
2. Përshtatjes së kurrikulës teorike, në mënyrë që njohuritë dhe kompetencat teorike, që fitohen në pjesën teorike, t'i përgjigjen më mirë standardeve të formimit teorik të nivelit Bachelor, si dhe të jenë lehtësisht të transferueshme / të aplikueshme në praktikën reale të sektorit.
3. Rritjes së ndjeshme të raportit që zë praktika profesionale në fermë/biznes brenda kohëzgjatjes normale, prej 3 vitesh akademike, të studimeve të ciklit të parë.
4. Organizimit të praktikës profesionale në një mënyrë të tillë, që ajo të realizoj një aftësim solid praktik të studentëve, përmes transferimit dhe aplikimit sa më të mirë të njohurive teorike, të fituara në auditor, në praktikën reale të fermës, sipërmarrjes/biznesit të sektorit të blegtorisë dhe nënsektorëve të lidhur me të.

Për këtë qëllim:

- a) Praktika profesionale në fermë/biznes është një praktikë e drejtuar dhe organizohet në “*module praktike*”;
 - b) Moduli praktik realizohet mbi bazën e një program të detajuar me fusha, i cili përfshin të gjithë elementët karakteristikë të Syllabus-it (sipas akteve rregullatore në fuqi - VKM, udhëzimi);
 - c) Praktika profesionale udhëhiqet kryesisht nga stafi akademik i departamentit dhe, sipas mundësive, nga stafi teknik i fermës/biznesit, si dhe nga specialistët e shërbimit të extensionit që këshillojnë fermat ku studentët zhvillojnë praktikën profesionale;
 - ç) Udhëheqja e studentëve nga stafi akademik i departamentit gjatë periudhës së praktikës profesionale realizohet përmes kombinimit të metodës Distance Learning me vizitat në fermë, për aq sa ato janë të domosdoshme. Distance Learning bëhet pjesë integrale komplementare krahas metodës kryesore në auditor;
5. Aplikimit të metodës së “*Të mësuarit të mbështetur në projekt*” (*Project-based learning*) ose të pavaruar (Indipendend learning) gjatë praktikës profesionale, i cili synon aplikimin dhe thellimin e njohurive teorike të një ose disa moduleve në praktikën reale, përmes punës së pavarur individuale ose në grup të studentëve, nën udhëheqjen e pedagogëve dhe, sipas mundësive, mbështetjen e stafit të fermës a biznesit ku studenti zhvillon praktikën. Udhëheqja e studentëve nga ana e pedagogëve për përgatitjen e Projektit në fermë/biznes realizohet përmes kombinimit të metodës së Distance Learning me vizitat në fermë, për aq sa ato janë të domosdoshme.

Riorganizimi i kurikulës aktuale do të realizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë, aktet nënligjore në fuqi (VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar) si dhe Rregulloren e FBM dhe Statutin e UBT.

1.4. Përshkrimi i ndryshimeve që bëhen në kurrikulën e riorganizuar.

Ndryshimet kryesore që bëhen në kurrikulën ekzistuese janë si më poshtë vijon:

1. Kurrikula përmban të njëjtën volum të punës mësimore prej *180 ECTS*, nga të cilat *140 ECTS* janë formim teorik dhe *40 ECTS* formim praktik, i cili realizohet si praktikë profesionale në fermë/sipërmarrje, duke përfshirë dhe mikrotezën Bachelor që realizohen gjatë kohës së praktikës profesionale.
2. Pjesa e formimi praktik rritet nga 5 ECTS në 32 ECTS, ndërsa për mikrotezën e Bachelorit parashikohen 8 ECTS nga 5 ECTS që parashikon kurrikula ekzistuese për provimin përfundimtar (32+8=40 ECTS).
3. Lista e moduleve, volumi i punës mësimore së tyre, raportet leksione/ushtrime, punë laborator, seminare, si dhe përmbajtja e tyre në vitin e parë, simestrat I dhe II, mbeten tërësisht të pandryshuar.
4. Në kurrikulën e *vitet të dytë*, lista e moduleve mbetet e njëjtë si në kurrikulën aktuale.

Në *simestrin III* zhvillohen modulet që janë lëndë zooteknike formuese bazë dhe programet apo pjesë të tyre nuk mund realizohen në praktikën e cdo ferme blegtorale. Këtu hyjnë modulet: Anatomia dhe Fiziologjia e kafshëve, Gjenetika e kafshëve dhe Përmirësimi gjenetik i kafshëve. Këtij grupi i shtohet një moduli “Metodat dhe aplikimet e bioteknologjisë në kafshë”, i cili nga viti i tretë planifikohet tani në këtë simestr.

Modulet e simestrit IV i përkasin shkencave zooteknike bazë të cilat kanë programe që aplikohen në cdo fermë blegtorale, pavarësisht nga specia. Këtu hyjnë modulet: Të ushqyerit dhe ushqimet e kafshëve; Higjiena dhe sëmundjet e kafshëve të fermës; Politikat e zhvillimit dhe këshillimi në blegtori; Drejtimi i fermave; Mekanizimi dhe ndërtimet në blegtori. Duke qenë se pjesa më e madhe e mësimave praktike, të planifikuara në auditor, të këtyre moduleve janë lehtësisht të aplikueshme në cdo fermë blegtorale, ky *simestr riorganizohet*, në mënyrë të tillë që gjitha pjesa teorike e leksioneve, seminareve dhe e punëve të laboratorike të domosdoshme të zhvillohet në 10 javë mësimore. Pjesa tjetër e programit të mësimave praktike të këtyre moduleve transferohen për t'u realizuar, gjatë periudhës së praktikës profesionale (shih moduli “*Praktika I*”), në ferma blegtorale, mjafton që ajo të ketë madhësi të mesme. Periudha e praktikës profesionale “*Praktika I*” përfshin 5 javët e mbetura të simestrit të zakonshëm dhe vazhdon edhe 5 javë të tjera, deri në fund të muajit korrik (gjithsej 10 javë).

Për ta ilustruar konceptin po i referohemi dy moduleve “Të ushqyerit të kafshëve” dhe “Ushqimeve & teknologjisë së përpunimit të tyre” të simestrit IV. Teknologjitë e prodhimit, përpunimit, konservimit, vlerësimit të cilësisë e sigurisë së ushqimeve, kombinimi i tyre në racione, teknika e optimizimit zooteknik dhe ekonomik të racioneve ushqimore të specieve të ndryshme, teknologjitë e të ushqyerit dhe ndikimet e tyre në cilësinë e produkteve blegtorale që prodhohen, si dhe në eliminimin e nutrientëve (sidomos N, P, K) në fermat e specieve të ndryshme të kafshëve përbëjnë pjesën kryesore praktike të moduleve “Të ushqyerit të kafshëve” dhe “Ushqimeve & teknologjisë së përpunimit të tyre”. Realizimi i kësaj pjese praktike direkt në fermë, pra në situatën konkrete nga praktika reale e fermës blegtorale, është një nivel cilësisht shumë më i lartë formimi, jo vetëm praktik por edhe teorik, sepse studenti e realizon këtë pjesë praktike, vetë, me duart e tij në fermë, mbi bazën e dijeve të fituara në klasë, i konsultuar nga pedagogët e moduleve, krahasuar me situatat e simuluar apo thjesht të demonstruara në klasë, ku studenti është më shumë vërtetues. Kjo është e mundur të realizohet në cdo fermë blegtorale. E njëjta situatë është me të gjithë modulet e këtij simestri.

Gjithashtu, gjatë praktikës profesionale (Praktika 1) të vitit të dytë, studentët, përveç programit të praktikës, realizojnë edhe një *Projekt Kursi (Project Work)* (shih Rezultatet dhe vlerësimi i Project Work në Praktika 1), i cili mbështetet në metodën Project-based Learning. Përmes këtij Projekti studentët kanë mundësi të thellohen në një nga modulet e simestrit të katërt, sipas një metodologjie të hollësishme dhe nën udhëheqjen e një pedagogu. Vëllimi i punës që i duhet studentit për të realizuar projektin, raporti (20-30 faqe) që do të përgatise studentin, si dhe mbrojtja e tij edhe me prezantim në PPT, përligj thellimin në një modul të përzgjedhur. Kjo i krijon mundësi studentit, që në vitin e dytë të studimeve, të realizoj preferencat e tij për t'u orientuar /thelluar në një fushë, të cilën, ai/ajo, nëse dëshiron, mund të vazhdoj ta thelloj më tej në vitin e tretë, përmes një projekti tjetër kursi, si dhe me mikrotezën e Bachelorit.

Në tërësi, riorganizimi i simestrit IV të vitit të dytë ndryshon **10 ECTS** të cilët transferohen nga auditori/klasa për tu realizuar gjatë praktikës profesionale direkt në fermë/biznes (shih *Moduli "Praktika 1"*).

5. *Viti III* i kurrikulës pëson riorganizimin kryesor, i cili realizon edhe integrimin më të madh të pjesës teorike me praktikën profesionale në fermë/biznese. Viti III i kurrikulës ekzistuese afron modulet që i përkasin shkencave zooteknike të aplikuara, të cilat fokusohen sipas specieve të kafshëve bujqësore dhe shpendëve, prodhimtarisë së tyre dhe cilësisë e sigurisë së produkteve blegtorale. Kurrikula ekzistuese ofron në simestrin V të gjithë modulet si të detyrueshme, ndërsa simestri VI përfshin 2 module të detyruara, 3 module me zgjedhje, praktikë profesionale (5 ECTS) dhe provimin përfundimtar të Bachelorit (5 ECTS). Në kurrikulën e riorganizuar ruhen të gjithë modulet e kurrikulës ekzistuese si dhe volumi i punës mësimore nuk pëson reduktim.

Ndryshimet e bëra në **vitin e tretë** janë si më poshtë:

a) *Viti i tretë* paraprihet nga një praktikë profesionale 4 javore (shih *Moduli "Praktika 2"*) në institucionet publike qendrore, rajonale dhe vendore që zhvillojnë politikën dhe menaxhojnë sektorin e blegtorisë. Në realizimin e Praktikës 2 departamenti bashkëpunon ngushtë me specialistët e institucioneve publike, pranë të cilëve do të jenë të atashuar studentët për katër javë.

b) *Simestri V* destinohet për të afruar të gjithë volumin e pjesës teorike të vitit të tretë, sa i takon leksioneve dhe mësimet laboratorike të domosdoshme që duhen bërë në klasë. Në simestrin V ruhen të gjitha modulet ekzistuese me vëllimin e ngarkesës mësimore, por ato afrohen jo për cdo specie por të grupuara në grup-specie (ripërtpësit, monogastrikët), për të mos rritur numrin e moduleve në simestrë. Një pjesë e formimit praktik të të gjithë moduleve të lëndëve të aplikuara realizohet direkt në praktikën e fermës në simestrin VI.

c) *Simestri VI* do të riorganizohet si semester i praktikës profesionale (shih *Moduli "Praktika 3"*). Në këtë simestrë studentët aplikojnë direkt në fermë njohuritë e marra në pjesën teorike të moduleve të simestrit V dhe thellojnë formimin e tyre praktik në modulet e specieve të ndryshme të kafshëve bujqësore, sipas strukturës së programit të praktikës profesionale në fermë, kapitujt përfaqësojnë objektivat e formimit praktik për modulet e ndryshme. Këto objektiva i realizojnë studentët në fermë (sic u shpjegua edhe më lart referuar simestrit IV - viti II), duke punuar vetë për të zhvilluar e zgjidhur detyra në formën e analizës dhe reflektimit për situatat konkrete të fermës ku ata kryejnë praktikën, mbështetur në dijet teorike – praktike të fituara në auditor në simestrin V dhe konsultimit me pedagogët përkatës

(kryesisht përmes Distance Learning- pedagogët organizojnë orët e konsultimit Online me studentët sipas moduleve).

Edhe në simestrin VI studentët kanë mundësi të thellohen në një fushë apo specie përmes një Projekt Kursi (Project Work), i cili ka në focus “*Manaxhimin (e integruar) zooteknik dhe ekonomik të një ferme blegtorale*”, ku studenti zhvillon një plan manaxhimi që përfshin të gjithë hallkat në fermën konkrete, si teknologjia e të ushqyerit, përmirësimi gjenetik, sistemi i mbajtjes, riprodhimi, prodhimi, cilësia dhe siguria e produktit primar blegtoral, ndikimet në mjedis si dhe ekonomia e prodhimit (analizë e kostos) që realizon ferma. Këtë projekt studenti e finalizon me një Raport të shkruar dhe një prezantim që mbrohet në departament (shih *Praktika 3*).

- d) Në Simestrin VI, pra gjatë periudhës së praktikës në fermë, përveç programit të praktikës 3, studentët realizojnë dhe përgatisin edhe *Projektin ose Mikrotezën Bachelor*, që përfaqëson edhe punën e parë me elementë kërkimor që realizon studenti në studimet universitare Bachelor. Departamenti shpall që në fillim të vitit të tretë të studimeve temat e Bachelorit dhe pedagogët udhëheqës shkencor. Cdo student përzgjedh një temë të aplikuar që lidhet me problematikën/veprimtarinë e fermës/biznesit ku ai/ajo zhvillon praktikën profesionale. Mikroteza Bachelor ka një volum formimi prej 8 ECTS.

Në tërësi riorganizimi i vitit të tretë ndryshon **20 ECTS nga 60 ECTS gjithsej të këtij viti**. Praktika profesionale rritet nga 5 ECTS në 22 ECTS, pra shton 17 ECTS, ndërsa për tezën e Bachelorit shtohen 3 ECTS përveç 5 ECTS që përmban kurrikula ekzistuese (17 + 3 = 20 ECTS).

1.4.1. Krahësimi i kurrikulës së riorganizuar me atë aktuale, sipas viteve të studimit.

Plani mësimor i riorganizuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Plani mësimor i riorganizuar i programit.

Nr	Moduli	Sim.	Orë/ javë	Orë gjithsej			ECTS	Workload, orë =ECTS x 25 h *
				Shuma	L	P		
	Viti I							
	Simestri I (15 javë)							
1	Matematika	I	4	60	30	30	6	
2	Kimi	I	3	45	30	15	4	
3	Fizikë dhe metereologji	I	4	60	30	30	6	
4	Botanikë e përgjithshme	I	3	45	30	15	4	
5	Biologji dhe mikrobiologji	I	6	90	45	45	7	
6	Gjuhë e huaj	I	2	30	0	30	2	
	Totali i simestrit I			330	165	165	29	725
	Simestri II (15 javë)							
7	Botanikë sistematike	II	3	45	30	15	4	
8	Kimi organike	II	3	45	30	15	4	
9	Informatikë	II	3	45	15	30	4	
10	Bazat e ekonomisë	II	3	45	30	15	4	

11	Bazat e prodhimit bimor	II	3	45	30	15	5	
12	Bazat e prodhimit shtazor	II	3	45	30	15	5	
13	Sociologji	II	2	30	15	15	3	
14	Gjuhë e huaj	II	2	30	0	30	2	
	Totali i simestrit II			330	180	150	31	775
	Totali I krediteve vitit I						60	1500
	Viti II							
	Simestri III (15 javë)							
15	Gjenetikë	III	4	60	30	30	5	
16	Përmirësimi gjenetik	III	5	75	45	30	6	
17	Ekologji	III	3	45	30	15	4	
18	Bazat e Anatomisë dhe Fiziologjisë së kafshëve	III	5	75	45	30	6	
19	Hyrje në akuakulturë dhe cilësia e produkteve ihtike	III	3	45	30	15	4	
20	Metodat dhe aplikimet e bioteknologjisë në kafshë	III	4	60	30	30	5	
	Totali i simestrit		25	360	210	150	30	750
	Simestri IV							
21	Të ushqyerit dhe cilësia e produkteve blegtorale	IV	4	60	30	30	5	
22	Ushqimet e kafshëve, përpunimi dhe siguria e tyre	IV	4	60	30	30	5	
23	Politikat e zhvillimit dhe këshillimi në blegtori	IV	3	45	30	15	4	
24	Sëmundjet e kafshëve të fermës	IV	3	45	30	15	4	
25	Higjena e Kafshëve	IV	2	30	15	15	3	
26	Mekanizimi në zootekni dhe ndërtimet blegtorale	IV	4	60	30	30	5	
27	Drejtimi i fermave	IV	3	45	30	15	4	
	Totali i simestrit		23	345	195	150	30	750
	Në Auditor (10 javë)				195	45	20	500
28	Moduli „Praktika 1“ (10 javë)	IV			0	105	10	250
	Totali i krediteve Viti II						60	1500
	Viti III							
29	Moduli “Praktika 2” (4 javë)						4	100
	Simestri V (15 javë)							
30	Prodhimtaria & cilësia e produkteve në ripërtypësit	V	5	75	45	30	6	
31	Prodhimtaria e monogastrikëve	V	5	75	45	30	6	
32	Prodhimtaria & cilësia e produkteve në shpendë	V	3	45	30	15	4	
33	Prodhimtaria & cilësia e produkteve në bletë	V	2	30	15	15	2	
34	Kontrolli i produkteve me origjinë blegtorale	V	3	45	30	15	4	
35	Tekno. e përpun. & gjurmueshmëria e prod. blegtorale	V	3	45	30	15	4	
36	Riprodhimi i kafshëve & Inseminimi artificial i kafshëve	V	3	45	30	15	4	
	Total i simestrit V		24	360	270	90	30	750
37	Moduli “Praktika 3” (20 javë)	VI					18	450
38	Mikroteza e Bachelor-it gjatë Praktikës 3	VI					8	200
	Totali i krediteve Vitit III						60	1500
	Totali I+II+III, javë	106					180	4500
	Teori (në auditor), javë	70					140	3500
	Praktikë profesionale në fermë/biznes	36					40	1000

*sipas akteve nënligjore në fuqi **1 ECTS = 25 orë pune**. Për mësimet në auditor, orët e kontaktit duhet të zënë jo më shumë se 50% të saj. Në përllogaritjet e paraqitura në tabelë, për vëllimin e ngarkesës është kalkuluar për **1 ECTS 11,5 – 12 orë kontakti në klasë/auditor**.

I) Krahاسimi i kurrikulës së riorganizuar me atë aktuale në Vitin e Parë:

- Asnjë ndryshim në kurrikulën e vitit të parë akademik, i cili është i njëjtë për disa programe studimi të FBM.
- Ekziston mundësia që të gjithë modulet të zhvillohen, sipas nevojës, bashkë me programet e tjera të FBM që kanë të njëjtin „trung të përbashkët“.

II) Krahاسimi i kurrikulës së riorganizuar me atë aktuale në Vitin e Dytë:

- Lista e moduleve të vitit të dytë ruhet sic është. Asaj i shtohet moduli “Metodat dhe aplikimet e bioteknologjisë në kafshë”, i cili spostohet nga viti i tretë, semestri V, në vitin e dytë, semestri III.
- Dy module (Të ushqyerit e kafshëve, Gjenetika e kafshëve) që kishin raport lexione/praktika 45/30 (6 ECTS), bëhen 30/30 (5 ECTS).
- Riorganizohet kalendari i procesit mësimor të semestrit IV, sic u përshkrua më sipër.
- Shtohet praktika profesionale që emërtohet **Moduli „Praktika 1“** që zgjat 10 javë dhe ka një volum mësimor ose formimi 10 ECTS (1 ECTS = 25 orë praktikë profesionale; 5 h/ditë ose 5 x 5 = 25 orë praktikë profesionale/javë). Praktika 1 përfshin 5 javët e fundit të semestrit IV dhe 5 javë të tjera deri në fund të muajit korrik (5+5 =10 javë praktikë profesionale në fermë/biznese). Volumi i formimit prej 10 ECTS përfaqëson pjesën e mësimave praktike të moduleve të semestrit IV që transferohet nga pjesa teorike (në auditor) për tu realizuar direkt në fermë (shih shpjegimi më lart), ka këtë shpërndarje sipas moduleve:

Mësime praktike që realizohen në fermë sipas moduleve:	ECTS
Të ushqyerit dhe cilësia e produkteve blegtorale	2
Ushqimet e kafshëve, përpunimi dhe siguria e tyre	2
Politikat e zhvillimit dhe këshillimi në blegtori	1
Sëmundjet e kafshëve të fermës	1
Higjiena e kafshëve	1
Mekanizimi në zootekni dhe ndërtimet blegtorale	2
Drejtimi i fermave	1
Gjithsej	10
Projekt Kurs (Project Work) në një nga modulet këtij semestri	

- Gjatë praktikës profesionale (Praktika 1) të vitit të dytë, studentët, përveç programit të praktikës, realizojnë edhe një *Projekt Kursi (Project Work)* (shih Rezultatet dhe vlerësimi i Project Work në Praktika 1), përmes të cilët ata kanë mundësi të thellohen në një nga modulet e semestrit të katërt që do të përgjedhin.
- Në tërësi riorganizimi në vitin e të dytë ndryshon **10 ECTS** të cilët përfaqësojnë një pjesë të mësimave praktike të moduleve të semestrit IV që transferohen nga pjesa teorike e kurrikulës për tu realizuar direkt në fermë (shih shpjegimi më lart). teorike në praktika profesionale në fermë/biznes.

- Ekziston mundësia që të zhvillohen leksione të përbashkëta për një pjesë të moduleve të simestrave III dhe IV, të cilët janë pjesë edhe e planit mësimor të programit tjetër Bachelor të ofruar nga DSHZ, "*Bioteknologji Zooveterinare*".

III) **Krahasimi i kurrikulës së riorganizuar me atë aktuale në Vitin e Tretë:**

Ndryshimet që bëhen në vitin e tretë janë shpjeguar në nënkreun paraardhës.

- Ekziston mundësia që të zhvillohen leksione të përbashkëta për një pjesë të moduleve të simestrit V, të cilët janë pjesë edhe e planit mësimor të programit tjetër Bachelor të ofruar nga DSHZ, "*Bioteknologji Zooveterinare*".
- Simestri VI është simestër i formimit praktik (shih moduli “Praktika 3”) dhe zgjat deri në fund të muajit korrik (gjithsej 20 javë). Ky simestër ka një volum formimi prej 18 ECTS për formim praktik në modulet e specieve të ndryshme të kafshëve dhe modulën e Riprodhimit dhe Inseminimit artificial të kafshëve të fermës dhe 8 ECTS për mikrotezën e Bachelorit që realizohet gjatë kohës së praktikës profesionale dhe më një temë që përfshihet në veprimtarinë prodhuese të fermës ku kryhet praktika. Për këtë qëllim, do të synohet që studentët të kryejnë praktikën profesionale “Praktika 3” jo në të njëjtën fermë ku kanë kryer “Praktikën 1”, në mënyrë që të kenë mundësi të fitojnë përvojë në më shumë specie (shih Shtojca 1: Organizimi i praktikës profesionale). Në funksion të këtij qëllimi, nëse do të jetë e mundur, mund të ndahet edhe periudha e “Praktikës 3” të kryhet në dy lloje fermash blegtorale. Ky alternativ është potencialisht i mundur për shkak të numrit të kufizuar të studentëve (rreth 25 studentë) që do të pranohen në këtë program. Megjithatë, kjo do të varet nga shpërndarja rajonale e fermave blegtorale të mesme dhe të vogla dhe mundësia e aksesit të studentëve për shkak të vendbanimit të tyre. Ky optimizim i zhvillimit të praktikës 3 në më shumë se një fermë blegtorale do të rritet nga viti në vit.

Thellimi i njohurive praktike në speciet e ndryshme realizohet në formën e *Manaxhimit zooteknik dhe ekonomik të fermës blegtorale të specieve të ndryshme* dhe pasqyrohet në programin e praktikës profesionale “Praktika 3”, në formën e kapitujve të mëposhtëm:

- a) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së gjedhit;
 - b) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së bagëtive të imta;
 - c) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së derri;
 - d) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së shpendëve;
 - e) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së bletëve & lepujve;
 - f) Manaxhimi zooteknik dhe ekonomik i fermës së kuajve;
 - g) Riprodhimi dhe inseminimi artificial i kafshëve në fermat blegtorale.
- Gjatë praktikës profesionale Praktika 3, të vitit të tretë, studentët, përveç programit të praktikës, realizojnë edhe një *Projekt Kursi (Project Work)* mbi “Manaxhimin zooteknik dhe ekonomik të fermës blegtorale”, përmes të cilët ata kanë mundësi të përzgjedhin dhe të thellohen më tej në një nga speciet e kafshëve, varësisht edhe nga lloji i fermës blegtorale ku studenti/tja zhvillon praktikën profesionale.

- Në Simestrin VI, pra gjatë periudhës së praktikës në fermë, përvec programit të praktikës 3, studentët realizojnë dhe përgatisin edhe *Projektin ose Mikrotezën Bachelor*, që ka një volum formimi prej 8 ECTS.
- Në tërësi riorganizimi i vitit të tretë ndryshon **20 ECTS nga 60 ECTS gjithsej të vitit të tretë të studimeve (shih më lart).**
- Numri total i krediteve që ndryshojnë nga riorganizimi në të tre vitet e studimeve të këtij programi është **30 ECTS nga totali prej 180 ECTS ose 16,7 %** e tyre.

1.5. Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë programin e riorganizuar.

Kurrikula e programit të riorganizuar do të vijojë të ofrojë:

Modulet e disiplinave bazë (kategoria A) zënë 21% të kurrikulës dhe afrojnë njohuri në shkencat natyrore dhe biologjike bazë, që shërbejnë për formimin e përgjithshëm dhe kryesisht për realizimin e kompetencave të formimit të përgjithshëm. Ato janë disiplina që afrohen për gjithë programin “Inxhinieri agrare” në vitin e parë dhe shërbejnë si bazë për shkencat zooteknike bazë e të aplikuara, si dhe disiplinat e tjera që afrohen në semestrat vijues të studimeve.

Lëndët karakterizuese/profilizuese (B) (55%), afrojnë njohuri të nevojshme teorike dhe praktike në (i) shkencat zooteknike bazë; (ii) shkencat zooteknike të aplikuara që lidhen me teknologjitë e mbarështimit dhe cilësinë e produkteve blegtorale që prodhohen në fermat e specieve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve bujqësore; (iii) modulet që lidhen me përpunimin e produkteve blegtorale si dhe kontrollin veterinar të tyre; (iv) modulet që lidhen me higjienën veterinare, mirëqenien dhe masat parandaluese ndaj sëmundjeve tek kafshët e fermës; si dhe (v) modulet e ekonomisë e manaxhimit të sipërmarjes në blegtori si dhe të standardeve mjedisore në fermat blegtorale. Nisur nga përcaktimi VKM 41 (24.1.2018) për këtë kategori “Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;” dhe nga vecoritë konkrete të këtij programi që ka në bazë integrimin e teorisë me praktikën në të gjithë modulet e përfshirë në pesë (i-v) grupet të sipër përmendura, kryesisht shkencat zooteknike bazë dhe ato të aplikuara të cilët realizohen përgjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve. Kësisoj, në këtë kategori janë llogaritur kreditet e këtyre moduleve në auditor si dhe kreditet e moduleve “Praktika 1” dhe “Praktika 3” sepse gjatë këtyre periudhave të praktikës në ferma/biznese, studentët realisht aplikojnë njohuri teorike të moduleve përkatëse në zhvilluara në auditor, realizojnë një pjesë të programit të formimit praktik të këtyre moduleve direkt në terrën, si dhe ata thellojnë njohuritë në module të vecanta përmes “Të mësuarit mbi bazën e projektit” (Project-based Learning) dhe Të mësuarit e pavaur.

Kategoritë A dhe B zënë 76 % të ECTC totale dhe plotëson më së mirë kriterin >70 % për programet Bachelor.

Lëndët ndërdisiplinore / integruese (C) (11 %), që përfshijnë nëndisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje, do të ndihmojnë që studenti të thellohet më tej sidomos në prodhimin bujqësor e blegtoral si dhe në sigurinë e produkteve blegtorale primare.

Lëndët plotësuese (D) (9%), që përfshijnë gjuhë të huaja dhe njohuri informatike dhe statistikore. Praktika profesionale në fermë nuk është llogaritur në këtë kategori, por në kategorinë B meqenëse zhvillohet e integruar me pjesën teorike.

Detymet përmbyllëse (E) (4%), përfshijnë mikrotezën e Bachelorit e cila zë 8 ECTS. Studenti përgatit tezën gjatë periudhës së praktikës profesionale në fermë/biznes, dhe zgjedh një temë të aplikuar që lidhet me problematikën e fermës/biznesit ku ai/ajo zhvillon praktikën profesionale.

Modulet	Kategoria (Simboli)	ECTS (%) Për kategori, (sipas VKM)	ECTS (%) Për kategori (BSc)
LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	A	15% - 20%	21%
LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore	B	50% - 55%	55 %
LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	C	12% -15%	11 %
LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe biostatistikore.	D	10-15%	7,6%
DETYRIME PËRMBYLLËSE	E	3%-5%	4,4%

Ky program është plotësisht i realizueshëm referuar burimeve njerëzore akademike dhe ato infrastrukturore të departamentit duke përmbyllur edhe kriteret e Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 *“Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”*. Staf i akademik i Departamenti i Shkencave Zooteknike, i cili sigurisht do të mbajë ngarkesën kryesore, është i kategorisë ‘Profesor’. Departamenti ka gjithashtu të gjithë infrastrukturën e nevojshme për hapjen e programit të ri. Pjesë përbërëse e DSHZ janë dy laboratorë të lidhur ngushtsisht me fushën: Laboratori i *"Bioteknologjisë së kafshëve"*, si dhe laborator i *"Cilësisë dhe Sigurisë së Ushqimeve për Blegtorinë dhe Akuakulturën"*.

Sic u shpjegua më lart, thelbi i riorganizimit të këtij program qëndron në integrimin e studimeve teorike me praktikën profesionale në fermë/biznes si dhe në institucionet publike të menaxhimit të sektorit të blegtorisë. Implementimi i praktikës profesionale është objektivi kryesor i një projekti Erasmus për krijimin e kapaciteteve. Në kuadër të këtij projekti, UBT bashkëpunon ngushtë me dy universitete partnere të vendeve të BE si dhe me aktorë të tregut të punës në vendin tonë (për më tepër shih shpjegimet e bëra në nënkreun 1.2.).

Meqënëse, riorganizimi i programit të studimit, konsiston, para së gjithash, në forcimin e formimit praktik përmes integritetit të studimeve me praktikën direkt në fermë/biznes, organizimi dhe zhvillimi i praktikës profesionale është paraqitur në shtojcën bashkëlidhur (shih Shtojca 1).

1.6. Kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët.

Kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët në programin e riorganizuar, ku studimet teorike në auditor kombinohen me praktika profesionale në ferma/biznese të sektorit të blegtorisë, rrjedhin nga përparësitë e këtij modeli.

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se studimet teorike në auditor të kombinuara me periudha të praktikës profesionale në ferma dhe biznese, kanë një sërë përparësish, si për cilësinë e formimit profesional teorik dhe praktik të studentëve, ashtu edhe për punësimin e hershëm të tyre pas diplomimit.

Përparësi kryesore të këtij modeli janë:

- a) Familjarizim i studentëve me fermën, biznesin në nënsektorin e blegtorisë dhe funksionimin e tyre që në vitin e dytë të studimeve. Kjo është një “botë” krejtësisht e panjohur për studentët që vijnë nga qytetet dhe nga gjimnazet. Studentët që kanë përfunduar shkollat e mesme profesionale të profileve të bujqësisë janë “në shtëpinë e tyre”, por nëse vijojnë studimet universitare Bachelor e shohin fermën nga një stad më i lartë i njohurive teorike të fituara gjatë kohës së studimeve.
- b) Përfitim i aftësive praktike e profesionale në kompani/ferma/biznese në sektorin e blegtorisë që gjatë kohës së studimeve.
- c) Njohje me mënyrën e funksionimit të fermës/biznesit, duke filluar me proceset më të thjeshta të përditshme, deri tek aspektet e drejtimit teknik zooteknik.
- d) Familjarizimi me fermën/biznesin dhe sektorin e bën më të lehtë dhe të natyrshëm kalimin nga universiteti/studimet universitare në punë/profesion.
- e) Punësim shumë i hershëm i të diplomuarve dhe një perspektivë shumë më e mirë në karrierën profesionale.
- f) Të diplomuarit kanë avantazh të madh në intervistat për punësim gjatë aplikimit, sepse ata janë të familjarizuar me fermën/biznesin dhe me kërkesat e punëdhënësve për stafet teknike, kanë njohuri të mira praktike dhe gjuhë komunikimi teknike të profesionit, cka e bën punëdhënësin të kursej kurset e zakonshme të trajnimeve që aplikojnë për të diplomuarit (për shkak të njohurive të pamjaftueshme praktike profesionale) dhe t’u besoj shumë më tepër kompetenca, që në fillim, specialistëve të rinj të rekrutuar (zakonisht punëdhënësit i konsiderojnë të diplomuarit e studimeve Duale si profesionistë të rinj, të cilët, nga ana praktike, janë që në ditën e parë të punës si “në shtëpinë e tyre”).
- g) Pritet që studimet e kombinuara me praktikën në këtë program, të tërheqin më mirë maturantët/studentët nga zonat rurale si dhe familjet fermere për t’u shkolluar dhe pastaj për të trashëguar fermën/biznesin nga prindërit e tyre.
- h) Pritet që studimet e kombinuara me praktikën në këtë program të tërheqin më shumë maturantë nga degët e bujqësisë dhe ato të ekonomisë e turizmit të shkollave të mesme profesionale. Në tërësi ky kontigjent është aktualisht rreth 1400 maturantë, nga të cilët rreth 400 maturantë i përkasin degëve të bujqësisë e blegtorisë të 8 shkollave të mesme profesionale.
- i) Studentët që kryejnë studimet Bachelor të kombinuara me praktikën vijnë në studimet e Masterit me kërkesa dhe motivacion cilësisht më të lartë. Ata vijnë me kërkesa shumë më të larta dhe me njohuri shumë më të mira praktike dhe teorike, cka do të përbëjë një shtysë edhe për rritjen e

nivelit teorik dhe praktik të studimeve të ciklit të dytë si dhe për orientimin e tyre më të mirë kah kërkesave të tregut të punës.

- j) Kombinimi i studimeve teorike në auditor me praktikën profesionale në fermë do të zhvesh pjesën teorike të studimeve nga mbingarkesa teorike e kurrikulës Bachelor (dukuri e jo rrallë kjo, edhe për shkak të rendjes pas ngarkesës së orëve). Kjo do të ndihmojë që të realizohet më mirë hierakia e nevojshme e formimit teorik dhe praktik në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, sipas standarteve internacionale. Nga ana tjetër, ko do të ndihmojë që kurrikulat e këtij programi në të dy ciklet, të përafrohen më mirë me ato të universiteteve të huaja për këtë drejtim studimi.
- k) Ky model i studimeve, përmes familjarizimit me fermën/biznesin, zhvillon tek studentët shumë herët shprehitë e sipërmarrjes, cka mund t'i ndihmojë ata të krijojnë fermat/bizneset e tyre pas studimeve, në mënyrë të vecantë, nëse ata do të mbështeten me grante apo incentiva të tjera për krijimin e bizneseve të reja nga të diplomuarit në shkencat bujqësore.
- l) Mbështetur në përvojën e universiteteve të vendeve të tjera, sidomos ato gjermane, studentët që studiojnë në programet e integruara me praktikën, mund të përfitojnë përvec diplomës Bachelor me Suplementin e saj, edhe *Certifikatë profesionale*, e cila evidenton formimin praktik të fituar. Ky program i riorganizuar, me një raport të tillë teori/praktikë (140 ECTS/40 ECTS), krijon mundësi reale për të pajisur studentët, në fund të studimeve, edhe me *Certifikatë të Formimit Profesional*, e cila i përgjigjet një profesioni të përfshirë në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP). Ligji i Arsimit të Lartë (80/2015), në nenin 81, krijon hapësirë të plotë për një vlerësim të tillë të praktikës profesionale. Kjo Certifikatë Profesionale, krahas Diplomës me Suplementin e saj, u shërben studentëve jo vetëm në punësim, por edhe në rastet e tjera kur ata krijojnë fermën/biznesin e tyre, etj. Me fillimin e implementimit të programit të riorganizuar do të zhvillohet dhe finalizohet edhe koncepti për këtë kualifikim plotësues profesional.

Fermat dhe bizneset në fushën e blegtorisë, të cilët do të kontribuojnë në formimin praktik të studentëve të këtij programi, mund të kenë disa përfitime. Të tilla janë:

- Njohja që gjatë praktikës e studentëve më të motivuar dhe më të përgatitur, për t'i rekrutuar ose për të marrë asistencën e tyre profesionale kur të fillojnë të ushtrojnë profesionin.
- Mundësia e pranisë së vazhdueshme në fermë/biznes të të rinjve studentë, cka i shërben edhe imazhit të fermës/biznesit në komunitetin dhe rajonin ku është ajo e lokalizuar.
- Mundësia e implementimit të ideve dhe projekteve të studentëve në fermë/biznes, të cilat mund të jenë interesante si produkte të imagjinatës së një brezi të ri që rritet dhe shkollohet në një “epokë” të re të teknologjisë së informacionit, dixhitalizimit etj. Studenti praktikant gjatë realizimit të programit të praktikës profesionale analizon situata konkrete të fermës dhe, pas konsultimit me pedagogët dhe stafin teknik të fermës/biznesit, reflekton mbi to duke propozuar edhe përmirësime, të cilat i vlerëson drejtuesi teknik se sa janë të implementueshme. Në këtë mënyrë vendoset një komunikim profesional midis fermerit, stafit të fermës, studentit dhe departamentit me përfitim reciprok.
- Vendoset një bashkëpunim cilësisht më i mirë i departamentit me praktikën, për shkëmbimin e përvojave, transferimin e njohurive si dhe zhvillimin e projekteve të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit në fermat/bizneset që kontribuojnë në formimin praktik të studentëve.
- Këto ferma/biznese do të zhvillohen dora dorës si ferma/biznese të trajnimit të studentëve. Në vendet me përvojë në studimet e integruara me praktikën dhe në sistemin Dual, ferma/biznese të tilla

gëzojnë një status të njohur nga shteti (p.sh. në Gjermani njihen si “*Lehrbetriebe*”), dhe, si të tilla, përfitojnë ato mbështetje financiare nga shteti për kontributin që japin në trajnimin praktik të studentëve dhe nxënësve.

Përparësitë e studimeve të kombinuara me praktikën në programin e riorganizuar zhvillojnë tek studentët kompetenca e mëposhtme:

- a) *Kompetenca të formimit të përgjithshëm në shkencat natyrore biologjike bazë dhe ato të formimit ndërdisiplinor bazë.*
- b) *Kompetenca profesionale në shkencat zooteknike, bazë dhe të aplikuara.*
- c) *Kompetenca profesionale në fushën e cilësisë dhe sigurisë së produkteve primare (pa hyrë në procesin e përpunimit) që prodhohen nga fermat blegtorale dhe përbëjnë ushqimet kryesore për njeriun.*
- d) *Kompetenca profesionale në fushën e mirëqenies dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve.*
- e) *Kompetenca profesionale në fushën e manaxhimit të sipërmarrjes në blegtori apo sektorë të lidhur ngushtë me të, sidomos tregtimi i produkteve blegtorale, prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i ushqimeve për blegtorinë, etj.*
- f) *Kompetenca profesionale në fushën e komunikimit, përfshirë komunikimin me fermerin, këshillimin dhe aplikimin/trasferimin e njohurive teorike në praktikën e profesionit.*
- g) *Kompetenca profesionale në fushën e ndikimit të blegtorisë në mjedis dhe vlerësimit mjedisor të fermave blegtorale.*
- h) *Kompetenca të avancuara praktike në organizimin e përgjithshëm dhe manaxhimin e përditshëm, si dhe në manaxhimin zooteknik dhe ekonomik të fermave blegtorale. Këto kompetenca studentët i fitojnë përmes punës praktike direkt në fermën blegtorale/sipërmarrje. Ato janë të vlerësuara dhe të pasqyruara edhe në suplementin e diplomës.*
- i) *Kompetenca analitike solide të zhvilluara dhe të konsoliduara përmes analizës së proceseve të ndryshme teknike dhe ekonomike të veprimtarisë së fermës apo biznesit dhe të finalizuara përmes raporteve të praktikës, detyrave të kursit, prezantimeve si dhe tezës së Bachelorit.*

1.7. Mundësitë e punësimit.

Sic u nënvizua në nënkreun 1.3., riorganizimi i programi është fokusuar në *forcimin e formimit praktik përmes integritit të pjesës teorike me atë të praktikës profesionale në fermë/sipërmarrje, pa cënuar madje duke e rritur cilësinë e formimit teorik që kërkojnë standartet e cilësisë për ciklin e parë të studimeve.*

Bazuar në përparësitë e modelit të studimeve të kombinuara me praktikën, si dhe në kompetencat profesionale dhe aftësitë që do të fitojnë studentët gjatë ciklit të studimeve, ata do të kenë mundësitë e mëposhtme të punësimit:

Në sektorin privat, si:

- a) Menaxher i fermës pronë e vetë ose i fermës me pronar tjetër;
- b) Specialist në fermat blegtorale, bujqësore ose të agroturizmit;
- c) Ndhmës Specialist në zyrat private të këshillimit të blegtorisë;
- d) Specialist/ekspert ose Ndhmës për të ushqyerit dhe përpunimin e ushqimeve pranë kompanive të ushqimeve për kafshët;
- e) Specialist/ekspert ose Ndhmës për përmirësimin gjenetik në kompanitë e racës dhe të materialit racor;
- f) Specialist/ekspert ose Ndhmës për cilësinë e produkteve blegtorale primare për fermat dhe kompanitë e industrisë ushqimore (në njësitë e vlerësimit të cilësisë së produkteve primare në fazën e grumbullimit);
- g) Specialist/ekspert ose Ndhmës në kompanitë e vendit dhe të huaja që mbulojnë ndërtimet, mekanizimin dhe automatizimin në blegtori;
- h) Specialist/ekspert ose Ndhmës në laboratorët privatë të cilësisë së produkteve blegtorale;
- i) Specialist/ekspert ose Ndhmës i marketingut në tregtimin e produkteve dhe nënprodukteve blegtorale;
- j) Specialist/ekspert ose Ndhmës në organizatat jo fitimprurëse që punojnë në fushën e blegtorisë, zhvillimit rural dhe mbrojtjen e mirëqënien e kafshëve.

II) Në sektorin publik si specialis ose Ndhmës-specialist me diplomë Bachelor në:

- a) Agropika dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë, të sigurisë ushqimore dhe në inspektoriate;
- b) drejtoritë/sectorët e këshillimit në blegtori;
- c) laboratorët e sigurisë ushqimore për fushën e sigurisë së ushqimeve për blegtorinë;
- d) drejtoritë/njësitë/sectorët e bujqësisë të bashkive: për fermat blegtorale dhe sigurinë e produkteve blegtorale;
- e) drejtoritë/njësitë/sectorët e mbrojtjes së konsumatorit të bashkive dhe ato rajonale;
- f) sektorët e statistikave në njësitë e pushtetit vendor.

1.8. Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët.

a) *Fillimi i zbatimit të programit të riorganizuar:*

Programi i riorganizuar fillon të zbatohet në **vitin akademik 2022-2023**.

b) *Kriteret e pranimit në programin e studimit* mbeten të pandryshuara.

Sic u shpjegua me lart, në këtë program studimi me një orientim praktik do ti jepet përparësi tërheqjes së disa kategorive të maturantëve si:

- maturantët që vijnë nga zonat rurale me më shumë blegtori;
- maturantët që vijnë nga familjet që kanë ferma ose biznese në bujqësi, blegtori, agroturizëm dhe biznese të tjera të lidhura me to;
- maturantët që kanë kryer shkollat e mesme profesionale në programet e bujqësisë, blegtorisë, ekonomisë dhe turizmit.

Për këtë program vlejnë të gjithë kriteret e tjera të pranimit që aplikon FBM për programet e tjera në shkencat bujqësore.

c) *Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.*

Në këtë program studimi do të pranohet numri minimal i lejueshëm për formimin e 1 grupi mësimor prej **25 studentësh**. Ky numër i mbyllur i pranimeve kushtëzohet nga natyra e programit të studimeve të kombinuar me praktikën profesionale në ferma/biznese, numrin e

fermave/bizneseve të mesme dhe të mëdha ku do të kryhet praktika profesionale si dhe vëllimi i madh i punës për departamentin për udhëheqjen e studentëve në realizimin e praktikës profesionale. Zakonisht programet e studimit të kombinuara me praktikën profesionale aplikohen për programe studimit që kanë numër të vogël studentësh.

d) **Tarifa e studimit.**

Tarifa e studimit mbetet e pandryshuar dhe ndjek politikat që ndjek UBT edhe për programet e tjera të ciklit të parë në shkencat bujqësore.

Riorganizimi i programit nuk parashikon kosto të vecanta të UBT për praktikat profesionale të studentëve në ferma. Prandaj, një ndër kriteret e shpërndarjes së studentëve në ferma do të jetë afërsia me vendbanimin e tyre, në mënyrë që studentëve të mos u rriten kostot krahasuar me ato që kanë aktualisht.

X
X X

Në tërësi riorganizimi i programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në „Zootekni dhe Siguria e produkteve blegtorale“:

1. Nuk ndryshon emërtesën e programit të studimit.
2. Nuk ndryshon kohëzgjatjen totale të programit. Studimet përfundojnë brenda 3 viteve akademike.
3. Nuk ndryshon numrin total të ECTS, pra mbetet 180 ECTS.
4. Riorganizon raportin e teorisë me praktikën në favor të rritjes së kësaj të fundit.
5. Riorganizimi ndryshon gjithsej 30 ECTS ose 16,7 % të numrit total të krediteve (180 ECTS).
6. Riorganizimi ruan raportin midis kategorive dhe veprimtarive formuese brenda kufive të përcaktuara në kuadrin regulator për studimet Bachelor.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se Riorganizimi i këtij programi mund të kategorizohet plotësisht si Riorganizim që përputhet me përcaktimin e Kreut IV, germa B, pika 4/e, të Udhëzimit të MASR, Nr. 1, datë 14.1.2020, sipas të cilit:

“e) në rastin kur riorganizimi i programit bëhet nën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite, për programe të akredituara, IAL-ja depoziton pranë MASR-së, vendimin e Senatit Akademik. MASR-ja njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit akademik. Ndryshimet nën 20% të shprehura në kredite të përmbajtjes së programit të studimit nuk duhet të ndryshojnë emërtesën e programit të studimit, por vetëm ndryshimet profilizuese. IAL-ja, nëse është e nevojshme, reflekton ndryshimet në diplomën e lëshuar“.